REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr.2900/3 Prot.

Vlorë më, 22.10.2026

VENDIM

Nr.30, datë 22/10 2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 26, DATË 17.11.2025, TË REKTORATIT, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SHËRBIMEVE NDAJ TË TRETËVE DHE TARIFAVE PËRKATËSE TË OFRUARA NGA DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA DHE DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE DHE LETËRSISË, FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE"

Në mbështetje të nenit 40 dhe nenit 25, pika 9 të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 26 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; nenit 15, pika 4, gërma c të Rregullores së Brendshme të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; Rregullores së Shërbimeve ndaj të tretëve në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë; si dhe referuar propozimit të Fakultetit të Shkencave Humane, përcjellë me shkresën nr.795/1 prot, datë 12.10.2026; Rektorati në mbledhjen e datës 22.10.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet e propozuara nga Fakulteti i Shkencave Humane mbi tarifat e shërbimeve ndaj të tretëve të ofruara nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane, sipas tabelës bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ky vendim përcillet për miratim të mëtejshëm në Senatin Akademik dhe miratim përfundimtarë në Bordin e Administrimit. .
3. Ky Vendim hyn në fuqi pas miratimit përfundimtar nga Bordi i Administrimit.

REKTORI

PROF. DR. AURELA SALIAJ

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

LISTA E SHËRBIMEVE NDAJ TË TRETËVE DHE TARIFAT PËRKATËSE

(për një ndryshim në listën e miratuar me Vendim të Rektoratit nr.26, datë 17.11.2025)

Nr.	Përshkrimi i shërbimit	Kohëzgjatja / Njësia	Tarifa (në lekë)
1. Kurse trajnimi dhe formimi gjuhësor			
a)	Kurs i gjuhës shqipe për studentë të huaj (niveli B1–B2)	45 orë	1500 Lekë/ora 67.500 Lekë/modul
2. Redaktimi gjuhësor			
a)	Redaktim gjuhësor i teksteve akademike		1.000 lekë / faqe
3. Organizim aktivitetesh			
a)	Organizim seminari / trajnimi (në auditorët e fakultetit)		4.000 lekë / ditë
4.	Testime dhe certifikimi gjuhësore		
a)	Testim gjuhë shqipe për nivelin B1/B2		7000 lekë
b)	Lëshim certificate competence gjuhësore		7000 lekë